



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Kllokot/Opština Klokot/Municipality of Klokot

KOMUNA E KLLOKOT

Korniza afatmesme buxhetore 2021 - 2023

Zyrtar Kryesor Financiar
Kelmend Rexhepi



30.06.2020

QESHOR 2020

Kryesuesi Kuvendi Komunal
Žarko Dejanovic



KORNIZA AFATMESME BUXHETORE KOMUNALE

2021 - 2023

Korniza afatmesme buxhetore komunale e Klllokot, është pjesë përbërëse e Kornizës afatmesme të shpenzimeve (KASH) të Kosovës, është e përpiluar në përputhje me procedurat buxhetore 2021-2023, të dhëna nga MF (Ministria e Financave) përmes Qarkores buxhetore 2021/01 për Komunitet si dhe financimi nga grandet ndërqeveritare dhe kufijtë fillestar të buxhetit komunal për vitin 2021 dhe parashikimet për -2022-2023. Korniza afatmesme buxhetore (KAB) komunale paraqet një mjet të procesit për zhvillimin e buxhetit që bënë ndërlidhjen e resurseve në dispozicion me prioritetet e komunës, duke u bazuar në qëndrueshmërinë e programeve komunale gjatë periudhës së ardhshme tri vjeçare. Me Kornizën Afatmesme Buxhetore – Komunale, do të paraqesim shpjegimet e politikave dhe prioritetet të tanishme dhe afatmesme të Komunës së Klllokot/Vërbovcit, si dhe projeksionet lidhur me mënyrën me të cilën buxheti i Komunës do të përmbush dhe përkrah projektet me prioritet, që do të përcaktohen sipas buxhetit për vitet 2021-2023 gjithnjë duke u bazuar në :

- Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal
- Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit
- Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale dhe
- Ligjin për Kufijtë Administrativ Komunal

❖ OBJEKTIVAT E KORNIZËS AFATMESME BUXHETORE KOMUNALE

Korniza Afatmesme Buxhetore për vitin 2021-2023 planifikohet në baze të Buxhetit i cili bazohet në "Buxhetin e Programeve " dhe është i orientuar në objektivat dhe në deklaratat e Misionit të Programeve . KAB 2021-2023 është krijuar në përputhje me udhëzimet e Qarkores Buxhetore nr 2021/01 e cila sfond të vetin dhe kontekst ka prioritetet e programeve dhe kursimet e shpenzimeve.

Është pjesë përbërëse e KASH-it të Republikës së Kosovës. Karakteristikë tjetër e buxhetit të tashëm është përfshirja e "Kornizës afatmesme të shpenzimeve". Kjo na ka mundësuar që të Planifikojmë të hyrat dhe shpenzimet jo vetëm për vitin pasus, por edhe për dy vite të ardhshme. Ajo që tani na duhet është definimi i " Misionit tonë" së paku për tri vite tjera të kthyera në objektiva, programe, veprime dhe shifra.

❖ Objektivat e Komunës së Kllokot/Vërbovcit:

- Mbrojtja, përmirësimi i ambientit dhe infrastrukturës së qytetit
- Kthimi i të zhvendosurve
- Zhvillimi i sferës së Shëndetësisë dhe Mirëqenies sociale
- Ngritja e nivelit të Arsimit dhe Edukimit
- Zhvillimi i sferës së Kulturës, Sportit dhe Rinis
- Promovimi dhe përkrahja e bizneseve të vogla dhe të mesme
- Përmirësimi i nivelit të kooperimit ndëretnik
- Zhvillimi i turizmit kulturor, historik
- Riatdhesimi i qytetarëve të kthyer.

❖ Objektivat shtetërore

- Përkrahjes dhe krijimit të parakushteve për rritje dhe zhvillim të qëndrueshëm ekonomik;
- Qeverisjes së mirë dhe fuqizimit të sundimit të ligjit;
- Zhvillimit të kapitalit njerëzor;
- Rritjes së mirëqenies sociale për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës

Siç mund të shihet objektivat e komunës janë të lidhura ngushtë me objektivat e shtetit të Kosovës.

Ky dokument ka për qëllim të:

- Promovojë disiplinën fiskale dhe të prezantojë vlerësime reale mbi nivelin e të hyrave buxhetore.
- Të prezantojë politikat fiskale në funksion të implementimit të politikave prioritetive të Qeverisë.
- Të sigurojë një ambient të qëndrueshëm makroekonomik, në funksion të zhvillimit të sektorit privat.
- Të përcaktojë kufijtë e shpenzimeve me qëllim që të sigurojë nivel të ulët të deficitit fiskal.

160	Zyra e Kryetarit
16036	Zyra e Kryetarit
163	Administrata dhe Shërbimeve komunale
16336	Administrata
	Shërbimet publike dhe shërbimeve të emergjencave
167	Prokurimi
169	Zyra e Kuvendit Komunal
16936	Zyra e Kuvendit Komunal
175	Buxheti dhe Financat
	17536 Buxheti dhe Financat
	Zhvillim ekonomik dhe turizëm
180	Shërbimet publike, mbrojtja civile, emergjenca
18196	Infrastruktura Publike
195	Zyra komunale për komunitete dhe kthim
470	Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural
650	Kadastër dhe Gjeodezi
660	Urbanizëm, Planifikimi hapësinor dhe mbrojtja e mjedisit
730	Shëndetësia dhe Shërbime sociale
	73045 Administrata
	75100 Shërbimet e shëndetësisë primare
850	Kultura, rinia dhe sportet
920	Arsimi dhe shkenca
	92180 Administrata
	92950 Arsimi parafillor dhe çerdhet
	94050 Arsimi fillor
	95250 Arsimi i mesëm

Në bazë të ligjeve në fuqi ne si komunë kemi bërë ndryshimin e statutit të komunës tek neni 35 kemi zbatuar procedurat për plotësim dhe ndryshim të statutit kemi formuar komisionin për plotësim ndryshim të statutit.

Komisioni ka zbatuar të proceduarat ligjore dhe ka hartuar planin e veprimit për ndryshimin dhe plotësimin e statutit në nenin 35 komisioni ka organizuar një debat publik me qytetar me datën 23.03.2018 para miratimit nga kuvendit komunal ndryshimin dhe plotësimin e statutit.

Debati është mbajtur në bazë të ligjit për vetë qeverisje lokale.

Qytetarë e komunës kanë rënë dakord për ndryshim dhe plotësim të statusit ekzistues në nenin 35 për të lehtësuar departamentet ekzistuese për efikasitet dhe funksionalitet të mirë të departamenteve komunale për të gjithë qytetarët që jetojnë në territorin e komunës. Nga 5 departamentet ekzistuese, janë ndarë kompetencave për 9 departamente të cilat do përbëjnë nenin 35 të statutit ekzistues të kuvendit komunal.

Drejtoritë ekzistuese:

1. Departamenti i Administratës, personelit, shërbimeve publike,
2. Departamenti për buxhet, financa dhe zhvillim ekonomik
3. Departamenti i Bujqësisë, Pylltarisë dhe menaxhimit të ujëvarave (mbetet i njëjte)
4. Departamenti i kadastrat, urbanizmit dhe gjeodezisë
5. Departamenti i arsimit, shëndetësisë, shërbimeve sociale, kulture, rini dhe sport

Drejtoritë e aprovuara nga Kuvendi komunal me datën 05.04.2018 me nr të arkivës 10307/2

- 1.1 Departamenti i Administratës dhe shërbimeve komunale,
- 1.2. Departamenti i shërbimeve publike dhe shërbimeve të emergjencave.
- 2.1. Departamenti për buxhet dhe financa,
- 2.2. Departamenti për zhvillim ekonomik dhe turizëm.
- 4.1. Departamentin për kadastrë dhe gjeodezi,
- 4.2. Departamentin për urbanizëm, planifikim hapësinor dhe mbrojtja e mjedisit
- 5.1. Departamenti për arsim, kulture, rini dhe sport,
- 5.2. Departamenti për shëndetësi dhe shërbime sociale.

Sipas nevojave të komunës

	2021	2022	2023
Pagat dhe mëditje	1,246,652.00	1,259,118.52	1,271,709.71
Mallra dhe shërbime	176,419.20	179,947.58	183,546.54
Shpenzimet Komunale	72,600.00	74,052.00	75,533.04
Subvencionet dhe transferet	9,836.88	10,033.62	10,234.29
Shpenzimet kapitale	454,864.92	463,962.22	473,241.46
Totali	1,960,373.00	1,987,113.94	2,014,265.03

Objektivat:

a). Shtimi i efikasitetit gjatë operacioneve

- Përmirësimi i efektivitetit në shpenzimin e buxhetit komunal
- Shfrytëzimi maksimal i burimeve
- Respektimi i afateve kohore gjatë kryerjes së punëve
- Kryerja e punëve në mënyrë të duhur
- Përzgjedhja e punëve më prioritet për realizim

b). Rritja e shpejtë e të ardhurave

- Rritja e efikasitetit në inkasimit
- Zgjerimi i bazës tatimore

c). Kontrolli i shpenzimeve dhe reduktimi i shpenzimeve

- Evitimi i shpenzimeve të panevojshme
- Planifikimi i shpenzimeve me kohë
- Përparësia nga blerja me shumicë
- Përmirësimi i specifikacionit për mallra dhe shërbime
- Planet për kursim nga shpenzimet – kontratat me afat të gjatë

d). Zhvillimi i aftësive

- Trajnimi për burimet dhe resurset njerëzore
- Përdorim i gjerë i kompjuterit
- Profesionalizimi i shërbimeve

e). Të sigurohet disiplina financiare

- Pajtueshmëria me politikën financiare, rregullat, rregulloret dhe me udhëzimet
- Ekzistenca e kontroleve interne – Auditori i Brendshëm
- Transparenca gjatë sjelljeve të vendimeve, informimi publik
- Analizat të vazhdueshme dhe sipas kërkesave të shpenzimeve
- Realizimi i Buxhetit sipas planit të rrjedhjes së parasë së gatshme (Kesh Plani)

f). Ekonomia

- Zhvillimi i strategjisë Komunale për promovim ekonomik
- Krijimi i kushteve për investime të huaja
- Strategjia për zhvillimin rural
-

a. Shqyrtimi dhe përmirësimi i sistemeve operative dhe transparencë

- Përmirësimi i politikës së prokurimit dhe procedurat
- Shënimet e duhura financiare dhe procedurat e kontabilitetit
- Inventarizimi i duhur dhe menaxhimi i pronës
- Koordinimet në mes departamenteve
- Përmirësimi i mbledhjes së të dhënave dhe analizat
- Menaxhimi i bazës së të dhënave dhe përhapja e informatave

b. Përmirësimi i bazës së të ardhurave

- Arkëtim më të madh të tarifave dhe ngarkesave që janë për t'u paguar
- Sa më shumë tatimpagues në rrjetin e tatimeve
- Ngarkesa (çmime) të reja për shërbime të reja
- Çmime (ngarkesa) të ndryshme
- Ngarkesa të reduktuara

c. Ristrukturimi organizativ

- Shqyrtimi i strukturës organizative Organogrami i Ri

Veprimet që kanë të bëjnë me objektivat

- Kontrolli për parandalimin e ndërtimit ilegal të shtëpive dhe objekteve tjera
- Zbatimi i rregulloreve komunale
- Shqyrtimi i planit të punës
- Përgatitja e buxhetit dhe planit të punës 2021
- Përgatitja e Kornizës së shpenzimeve afatmesme 2021-2023
- Përgatitja e planit urbanistik , rregullativ dhe detal
- Përmirësimi i mbledhjes thelbësore të dhënave dhe përdorimi
- Shqyrtimi i përgjegjësive dhe i obligimeve komunale
- Menaxhimi i projekteve
- Vlerësimi

Udhëzimet kryesore nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë janë:

(a) LIMITET e grandeve që do t'i caktojë Qeveria Qendrore për Komuna

(b) Buxheti duhet të jetë I BALANCUAR. Kjo do të thotë se Komuna NUK MUND TË bëjë planin për shpenzime e cila tejkalon grandet e lejuara dhe nuk mund të përgatisë buxhetin deficitar.

1.1. Korniza makroekonomike

Korniza makroekonomike është në përputhje me kornizën makroekonomike të Kosovës dhe sipas dokumenteve të Kornizës afatmesme të shpenzimeve (KASH).

KASH-i- Duhet të strukturoret brenda një kornize makroekonomike disavjeçare që merr parasysh vlerësimin e shpenzimeve dhe të hyrave të gjithëmbarshme qeveritare. Një KASH i mirë merr parasysh shpenzimet periodike ashtu edhe investimet kapitale. (KASH-i)-Është një buxhet i integruar dhe që përbën prioritetet (një minimum prej tri vitesh) për implementimin e Planit Strategjik.

1.2 Qëllimi i KASH-it

- Përmirësimi i para-shikueshmërisë së buxheteve;
- Rritja e qëndrueshmërisë së buxhetit;
- Sigurimi i kalimit të financimit nga donatorët drejt përkrahjes së përgjithshmebuxhetore,
- Forcimi buxhetit të orientuar nga rezultatet, që fokusohen në përmirësimin e ofrimit të shpenzimeve dhe
- Planin e Veprimit të Partneritetit Evropian (PVEP).

Përfitimet nga KASH-i janë shumë dimensionale dhe për arsye ilustruese mund të kategorizohen në tri grupe kryesore: Kredibiliteti, Strategjia dhe Transparenca.

1.3 Perspektiva e politikave fiskale

Një vëmendje e veçantë duhet kushtuar politikave fiskale (politikës së të ardhurave si nga granditë qeverisë, të hyrave vetjake komunale si dhe shpenzimeve.

- Me kornizën afatmesme të shpenzimeve 2021-2023 është parapare ndërmarrja e një varg masash duke filluar nga kursimet në kategorinë e shpenzimeve publike –si rezultat i rekomandimeve të FMN-së¹ deri të marrja e masave konkrete në realizimin e të Hyrave në nivel Qendror dhe Lokal . Psh.
- Kontroll më i ngushtë dhe mbledhje e detyrueshme për ngarkesat dhe tarifat e mbledhura në nivel lokal.
- Sensibilizim i qytetarëve për të kryer obligimet ndaj Komunës

Korniza makroekonomike e komunës është sipas Qarkores nr. 2021/01 për Komuna

Korniza Afatmesme Makroekonomike e Komunës sonë është ne përputhje me Kornizën Afatmesme Makroekonomike të Kosovës dhe dokumenteve që dalin nga Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH).

Ne përgjithësi mund të thuhet se fondet nga Grandi Qeveritar dhe Te Hyrat Vetjake Komunale për momentin nuk paraqesin potencial të mjaftueshëm financiar për zhvillimin e komunës.

Nr.	Programi buxhetor	Plani 2021	Vlerësimi 2022	Vlerësimi 2023
1.	Administrata e Përgjithshme	373,418.00€	418,582.00€	420,726.00€
2.	Arsim dhe Shkenca	461,992.00€	482,158.00€	504,165.00€
3.	Shëndetësia	118,841.00€	179,043.00€	179,939.00€
4.	Të hyrat Vetanake	158,842.00€	176,377.00€	184,118.00€

1.4 Parashikimi i të hyrave komunale

Të hyrat komunale të komunës sonë realizohen në bazë të Ligjit mbi Financat e Pushtetit Lokal, Rregullores mbi Tarifat dhe Ngarkesat Komunale, Rregullores mbi tatimin në Pronë si dhe dispozitave tjera ligjore të cilat përcaktojnë llojet e ndryshme të hyrave komunale me të cilat komuna ka të drejtë të caktoj dhe inkasoj siç janë licencat e bizneseve dhe të hyrat tjera vetjake komunale.

Bazën e të hyrave komunale e përbëjnë Tatimi në pronë, të cila të hyra duhet shpenzuar dhe ekskluzivisht dedikohen në sferën e projekteve dhe investimeve kapitale në infrastrukturën rrugore, ujësjellës, kanalizim dhe investime tjera që ju kthehen qytetarëve (tatim paguesve) në investime dhe ngritjen e infrastrukturës komunale.

Hytrat e Komunës përbëhen nga:

- ✓ Tatimi në pronë
- ✓ Taksat për ushtrim të veprimtarisë afariste
- ✓ Taksat për lejen për shërbime profesionale
- ✓ Taksa për automjete motorike
- ✓ Taksa administrative komunale
- ✓ Taksa për leje ndërtimi
- ✓ Taksa për certifikata
- ✓ Renta e tokës
- ✓ Të hyra tjera

Përveç të hyrave nga tatimi në pronë edhe taksa komunale në biznes tregon një kategori të rëndësishme të të hyrave vetjake komunale . Gjate planifikimit të kësaj kategorie kemi pas parasysh që një numër i konsiderueshëm i bizneseve komunale nuk janë duke funksionuar. Taksa komunale për leje ndërtimi është gjithashtu një kategori e rëndësishme e të hyrave , gjatë planifikimit të kësaj kategorie komuna ende nuk është e sigurt me kategorinë e legalizimeve të objekteve të ndërtuara pa leje.

Tabela 2. Parashikimi i të hyrave buxhetore komunale

Planifikimi i të Hyrave Vetanake Komunale për vitin 2020 - 2022

Komuna:		Formulari THV - 2020 në Euro	Formulari THV - 2021 në Euro	Formulari THV - 2022 në Euro
Nr.ren.	Burimet e të Ardhurave	Totali	Totali	Totali
I-A.	TË ARDHURAT E ADMINISTRATËS KOMUNALE - Direkte			
1	Liçensat dhe Lejet	10,000	13,000	12,000
1.1.	Liçensat dhe Lejet	10,000	13,000	12,000
4	Shfrytëzimi i Tokës dhe Lejet e ndërtimit	4,000	5,000	5,000
4.1.	Lejet për ndërtim dhe konstruktive	4,000	5,000	5,000
7	Shfrytëzimi i pronës Komunale	27,660	27,660	27,660
7.1	Marrja me qira e objekteve komunale për një afat të gjatë	27,660	27,660	27,660
8	Pagesat në lidhje me Automjetet	6,000	5,000	5,000
8.1.	Regjistrimi i automjeteve	6,000	5,000	5,000
9	Çertifikatat dhe Dokumentet Zyrtare	5,000	4,000	4,500
9.1.	Dokum.lidhur me statusin shoqëror si dhe të lindjes,vdekj,martësës,shkurorizimit	5,000	4,000	4,500
10	Taksa e pronës	91,932	99,673	107,414
10.1.	Pagesat e taksës së pronës	81,932	74,673	87,414
10.2	Tatimi ne toke	10,000	25,000	20,000
11	Të ardhurat tjera	14,250	22,044	22,544
11.0.	Taksat per mbeturina	7,000	9,522	13,948
11.2.	Pagesat tjera	7,250	12,522	8,596
I-A.	Nëntotali I-A , Të ardhurat direkte (Tarifat dhe ngarkesat)	158,842	176,377	184,118
I	Totali I Administrates komunale (Direkte dhe Indirekte & IA+IB)	158,842	176,377	184,118

1.5 Vlerësimet e hershme të programeve buxhetore

Me vlerësimet e hershme të shpenzimeve buxhetore përfshihen, kornizat e shpenzimeve të secilit program buxhetor, duke u bazuar në burimet e të hyrave duke u modifikuar vetëm nga treguesit makro-ekonomik dhe fiskal dhe duke pas për bazë buxhetin e aprovuar për vitin 2020.

Kjo kornizë paraqet parashikimin 3 vjeçar të shpenzimeve të përgjithshme komunale. Të hyrat komunale janë paraqitur me një trend të rritjes për çdo vit, si dhe të grandeve të qeverisë të cilat më pastaj do të inkorporohen në vlerësimet pasuese të shpenzimeve buxhetore sipas Qarkoreve Buxhetore dhe limiteve të buxhetit, të cilat do të përcaktohen nga Komisioni i grandeve të MF-it.

T'ju përkujtojmë se Grandi i përgjithshëm nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Grandi specifik për Arsim dhe Shëndetësi sipas viteve është :

Viti	Granti i Përgjithshëm	Granti specifik për Arsimin	Grandi specifik për Shëndetësi	Të hyrat vetanake ^{2*}
2021	461,992.00€	373,418.00€	118,841.00€	158,842.00€
2022	482,158.00€	418,582.00€	179,043.00€	176,377.00€
2023	504,165.00€	420,726.00€	179,939.00€	184,118.00€

Sipas qarkorës buxhetore 1/2021

1.6Projeksionet e shpenzimeve të buxhetit komunal

Shpenzimet e Përgjithshme :

Çmimi i materialit dhe i shërbimeve që merren në tregun e hapur duhet të vlerësohet në mënyrë reale. Nuk është lehtë të merren informata themelore që janë esenciale për të bërë parashikimin. Komuna nuk ka kompetenca të kontrolloj vënien e tatimit në taksa të importit. Ngjashëm me këtë. Komuna nuk ka ndikim në shkallën e përgjithshëm të çmimit dhe të rritë apo të ulë çmime

e shërbimeve siç janë:

Rryma elektrike, Uji, Shërbimet e Telefonit, Ngrohja, Heqja e mbeturinave dhe
shërbimet tjera.

Shpenzimet në këto shërbime po ngritën dhe është nevojë urgjente që të kontrollohen çmimet. Këto shpenzime mund të kontrollohen me shfrytëzim racional, me marrëveshje për shërbime dhe me praktikë të mirë të prokurimit.

- Masat që duhet ndërmarrë për kursimin e mjeteve

Shfrytëzimi joekonomik i materialit shpenzues i zyrave është çështje tjetër për brengosje. Edhe pse duket si çështje e vogël, shfrytëzimi i duhur i materialit do të kursente para të konsiderueshme. Rekomandohet përmirësimi në vijim i procedurave të prokurimit dhe i praktikave. Prokurimi i materialit me kohë, dhe në tregun konkurrues përfundimisht zvogëlon shpenzimet.. Nevojitet planifikimi paraprak dhe procedurat e duhura.

djegëse gëlltisnin shumë të madhe të mjeteve . Rregullat struktë dhe politika e qartë e përcaktuar dhe praktika duhet të futen në përdorim.

Kursimet ne shfrytëzimin e PTK gjithashtu kane domethënie ne kursimet e tera

Shfrytëzimi ekonomik për mirëmbajtjen e Auto veturave dhe pajisjeve

Kursimi i energjisë elektrike

2. Programi komunal i investimeve publike (PIP)

Programi komunal për Investime publike përfshinë të gjitha projektet e aprovuara sipas prioriteteve të përcaktuara me Buxhetin për vitet 2021/2023 nga ana e Kuvendit të Komunës së Kllokot/Vërbovc, sipas proceseve buxhetore të zhvilluara gjatë vitit 2021.

Për projektet e vitit 2021 te financuara nga të hyrat vetanake, si dhe projektet sipas prioriteteve për vitet 2022/23. Për këto projekte nga Drejtorit përkatëse si dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa janë hartuar formularët me arsyetimet përkatëse për projektet me prioritet për financim.

Është hulumtim i potencialit dhe burimeve të mundshme për financim të zbatimit të Planeve

Zhvillimore, si dhe drejtimit te Investimeve Kapitale Publike nga sektori publik duhet të përfshijë kontributet potenciale financiare nga kapacitetet ekzistuese dhe atyre te mundshme. Kapacitetet ekzistuese përfshijnë:

- Buxhetin komunal, sektorin privat, sektorin publik, burimet natyrore, kapacitetet e infrastrukturës fizike (ndërtesat), potenciali njerëzor (rinia)

Ndërsa kapacitet e mundshme përfshijnë:

- Investimet nga jashtë, fondet ndërkombëtare, Pakti i Stabilitetit, BE dhe donacionet Tjera dhe investimet e mundshme prej Qeverisë

Shumë komuna në Evropë dhe në Shtetet e Bashkuara, duke përfshirë edhe ato në Kosovë, kanë rol qendror në prioritizimin e investimeve kapitale dhe në aranzhimin e investimeve lokale përmes mekanizmave të cilat i kanë në dispozicion. Kjo mund të përfshijë gjenerimin e të hyrave lokale, vjeljen e taksave dhe tarifave, zhvillimin e partneriteteve publikeprivate, aranzhimin e ndarjes së drejtë të projekteve kapitale.

Komunat po bëhen gjithnjë e më të vetëdijshme se investitorët ndërkombëtarë dhe të brendshëm, Kryetari i Komunës dhe Zyrtari Kryesor Financiar së bashku me Kuvendi komunal si organ legjislativ dhe Komiteti për politikë dhe financa janë përgjegjëse për përgatitjen e buxhetit, i cili përfshinë programin e investimeve kapitale dhe buxhetin.

Draft propozimi i Programit komunal për Investime publike përfshinë të gjitha Kërkesat – Propozimet fillestare të Drejtorive komunale (Programeve buxhetore) – Projektet e propozuara sipas prioriteteve të përcaktuara me Buxhetin për vitet 2021/23 sipas proceseve buxhetore të zhvilluara gjatë këtij vitit, dhe të cilat projekte përfshijnë një lëmi të gjerë të zhvillimi të gjithëmbarshtëm të Komunës

Zyra e Kryetarit

Kryetari: Bozidar Dejanovic

Zyra e Kryetarit

Deklarata e misionit: Në bazë të Ligjit Nr. 03/L – 040 Mbi vetëqeverisjen lokale Zyra e Kryetarit të Komunës, respektivisht Kryetari si organ i Komunës, ka këto përgjegjësi:

Kryetari duke përfaqësuar Komunën dhe duke vepruar në emër të saj udhëheq Ekzekutivin e Komunës dhe Administratën e saj dhe mbikëqyrë administrimin financiar të komunës duke ushtruar të gjitha kompetencat, të cilat nuk i jepen në mënyrë eksplicite Kuvendit të Komunës apo komiteteve të tij, ekzekuton aktet e Kuvendit të Komunës, organizon punën dhe drejton politikën e komunës, propozon rregullore apo akte të tjera për miratim në Kuvendin e Komunës, si dhe nxjerr urdhëresa dhe vendime brenda fushës së kompetencave të tij, propozon zhvillimin komunal, planet rregullative dhe investuese, propozon buxhetin vjetor për miratim në Kuvendin e Komunës dhe e ekzekuton buxhetin e miratuar, raporton para Kuvendit të Komunës për situatën ekonomiko-financiare të komunës dhe për zbatimin e planeve investuese të Komunës, si dhe ndërmerr aktivitetet tjera që i caktohen me statut, rregullore komunale apo dispozita tjera ligjore në fuqi.

Përgatitë të gjitha materialet për mbledhjet e Kuvendit të Komunës, komiteteve të përhershme dhe atyre ad hoc, gjithnjë me qëllim të arritjes të një qeverisjeje sa më të mirë, koordinon punën me të gjitha drejtoritë e Kuvendit të Komunës gjithnjë në shërbim të gjithë qytetarëve të Komunës. Ofron qasje në dokumente zyrtare në mënyrë të arritjes së një transparence sa më të madhe në punë, etj.

Kuvendi Komunal

Kryesues i Kuvendit: Zharko Dejanovic

Kuvendi i Komunës

Deklarata e misionit: Kuvendi i Komunës dhe organet e tij (komitetet e përhershme dhe ato ad hoc), me subjektet relevante të nivelit qendror dhe ato lokal, OJQ-të, bizneset etj, me qëllim të ofrimit sa më të mirë të shërbimeve ndaj qytetarëve, angazhohet për një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm të Komunës në përgjithësi dhe me këtë edhe të ngritjes së mirëqenies për të gjithë qytetarët e Komunës sonë, duke përfshirë këtu ndërmarrjen edhe të aktiviteteve tjera të domosdoshme për kujdesin që qytetarët e Komunës të gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë pa dallim.

Drejtoria e Administratës dhe Shërbimeve komunale

Milena Marinkovic

Deklarata e misionit :

- Zbatimin e dispozitave ligjore, rregulloreve në organet e administratës komunale
- Organizon metodën e punës në organet komunale të administratës,
- Lëshon certifikata dhe akte tjera nga evidenca zyrtare që mban kjo drejtori,
- Planifikon buxhetin e Drejtorisë dhe kujdeset për menaxhimin optimal të tij,
- Kryen punët administrative për nevojat e këtyre organeve që kanë të bëjnë me :
- Përgatitjen profesionale, teknike dhe organizimin e mbledhjeve të Asamblesë Komunale, Bordit të Drejtorëve dhe trupave punues të emëruar nga Asambleja Komunale dhe Bordi i Drejtorëve si dhe përpunimi profesional të akteve të miratuara nga këto mbledhje.
- Punët e përbashkëta për të gjitha organet e administratës: Punët e pranimi të shkresave të ndryshme, dorëzimin dhe ekspeditivin e shkresave zyrtare , vërtetimin e dokumenteve dhe nënshkrimin, punët e arkivues dhe ekspeditimit, zbatimin e procedurave ligjore nga lëmi e marrëdhënies së punës, mirëmbajtjen dhe pastrimin e objekteve, prokurimin dhe furnizimin me mallra dhe shërbime, nxehjen qendrore, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e automjeteve të KK dhe mirëmbajtjen e rrjetit të kompjuterëve.

Bazuar në Ligjin e Republikës së Kosovës për Vetëqeverisje Lokale të Komunave

,konformvendimit të Kuvendit të Komunës së Kllokot,për restrukturimin e drejtorive të Kuvendit të Komunës është formuar Drejtoria për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë, me çrast sektori për zhvillim ekonomik është bashkuar me Drejtorinë për Financa dhe Ekonomi,sektori për ekonomi publike është shndërruar në sektorë për shërbime publike ,ndërsa është formuar edhe sektori për infrastrukturë.

Konform vendimit të Kuvendit dhe procedurave administrative ,drejtoria aktivitetet i filloi duke pasur obligim parësor përpilimin e organogramit,staffit profesional,përgjegjësi (konform vendimit),programit të punës duke u bazuar në buxhetin komunal dhe objektivat e qeverisë komunale, si dhe vazhdimin e punëve të planifikuara nga Drejtoria pararendëse për Ekonomi dhe Zhvillim.

Për shkak të specifikave që e ngarkojnë drejtorinë , përgjegjësitë janë ndarë në dy sektor :

► Sektori për Shërbime Publike në të cilën bëhet planifikimi dhe përcaktimi i ofrimit të shërbimeve komunale për qytetarët,koordinimi i punëve me ndërmarrjet publike dhe ndërmarrje komunale.Sektori për shërbime publike gjithashtu do të merret me mirëmbajtjen dhe riparimin e rrugëve- verore dhe dimërore,mirëmbajtjen dhe shtimin e sipërfaqeve të gjelbëruara,mirëmbajtjen dhe zgjerimin e rrjetit të ndriçimit publik,mirëmbajtjen e rrjetit të kanalizimit të ujërave atmosferike,shenjëzimin horizontal dhe vertikal dhe rregullimin e sistemit të transportit publik,ndërtimin dhe funksionimin e tregjeve,mirëmbajtjen e varrezave dhe lapidarëve si dhe në perspektivë me nxemjen qendrore dhe energjinë ekologjike.

► Sektori për Infrastrukturë i cili në kuadër të kompetencave bënë planifikimin e investimeve kapitale në ndërtim,riparim dhe mirëmbajtjen në infrastrukturën e qytetit,konkretisht do të merret me ndërtimin dh rindërtimin e rrugëve lokale,ndërtimin e rrjeteve të ujësjellsit,ndërtimin e rrjeteve të kanalizimit të ujërave të zeza dhe ujërave atmosferike,ndërtimin e parqeve dhe shesheve si dhe kujdesin për trajtimin e ujërave të zeza dhe mbeturinave të ngurta

Deklarata e Vizionit :

- Lëshon deklarata për amvisnin e përbashkët,
 - Bën vërtetimin e fotokopjeve të dokumenteve origjinale
 - Bën vërtetimin e nënshkrimeve personale
 - Lëshon vërtetime për varshmërinë materiale në diasporë etj,
 - Lëshon certifikata në bazë të dy dëshmitarëve dhe provave tjera,
 - Përgatit aplikacionet për marrjen e patentë shoferëve dhe bënë shpërndarjen e tyre,
 - Protokollon, pranon shkresat nga palët, sistemon, evidenton dhe dërgon aktet në përpunim të mëtejshëm sipas drejtorive dhe sektorëve të veçantë dhe bën ekspeditivin e akteve zyrtare e materiale për nevojat e Kuvendit Komunal,
 - Përpunimi administrativ-teknik i akteve dhe i lëndëve, pranimi , hapja, klasifikimi i postës, dërgimi i postës, arkivimi lëndëve, ruajtja e lëndëve arkivore të përfunduara
 - Ndarja e materialit të pavlefshëm të regjistraturës dhe dorëzimi i lëndës arkivore ,arkivit kompetent, shpend e thirrjeve përmes centralit telefonik etj
-
- Zbatimin e përpikët të rregullativës ligjore
 - Ofrimin e shërbimeve komunale cilësore dhe më kohë për qytetarët
 - Investime në rregullimin e infrastrukturës
 - Sigurimin e donacioneve të brendëshme dhe të jashtme për përmirsimin e infrastrukturës
 - Krijimi i projekteve në infrastrukturën publike me qëllim të krijimit të vendeve të punës sezonale në bashkëpunim me UNDP-në
 - Pastrimi i lumenjëve të qytetit
 - Participimi në investime dhe pastrimin e kanalizimeve të ujërave të zeza në qytet
 - Analiza lidhur me problematikën e shfrytëzimit të hapësirave publike
 - Funksionalizimi i tregjeve dhe qendrave të bizneseve të vogla

Deklarata e Qëllimit :

- Drejtorja e Administratës dhe shërbimet komunale ka për qëllim të bëjë:
- Regjistrimin e posalindurve në LAL
- Regjistrimin e të vdekurve në LAV
- Celebrimin e martesave dhe i regjistrojnë në LAM,
- Mbanë librat amzë të lindurve,
- Mbanë librat amzë të martuarve
- Mbanë librat amzë të vdekurve
- Bënë ndryshime dhe përmasime të emrave personale sipas kërkesës së palës
- Lëshon certifikata për faktet që mbajnë evidencë sipas detyrës zyrtare,
- Kryejnë edhe punë tjera të përcaktuara me Ligj dhe aktet nënligjore,
